

NJOFTIM PUBLIK

Mbyllja e procesit të shqyrtimit publik për Draft-Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri” dhe Draft-Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Parkut Kombëtar “Sharri”

Të nderuar qytetarë, përfaqësues të institucioneve, komuniteteve lokale, bizneseve dhe palëve të interesuara,

Procesi i shqyrtimit publik për Draft-Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, i hapur më 02.04.2025, është zgjatur përtej afatit të paralajmëruar fillimisht. Arsyeja e shtyrjes ka qenë fakti se kërkesat dhe propozimet nga publiku janë pranuar në mënyrë të vazhdueshme edhe pas afatit fillestar, me qëllim që ky proces të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe transparent.

Megjithatë, duke marrë parasysh se tashmë kanë kaluar gati pesë muaj nga hapja e procesit dhe frekuenca e paraqitjes së kërkesave është zvogëluar ndjeshëm, pothuajse duke u ndërprerë, është vendosur që ky proces të përmbyllet.

Data përfundimtare e pranimit të kërkesave dhe komenteve është 01.09.2025.

Pas kësaj date, kërkesat dhe komentet e reja nuk do të pranohen dhe nuk do të trajtohen më në kuadër të këtij procesi.

Falënderojmë të gjithë të interesuarit për angazhimin dhe kontributin e dhënë deri më tani, të cilat do të shërbejnë për përmirësimin dhe finalizimin e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës